



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 560/4 Prot

Tiranë, më 11/06/2020

VENDIM

Nr. 13, datë 11.6.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 560 Prot., datë 20.05.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Inspektoriatit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet shkresës datë 11.03.2020, depozituar në adresën ervis.bedo@slj.gov.al, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

- 1- Vendimin përfundimtar në të cilin përmbledhet përgjigjia e ankesës.
- 2- Të gjithë praktikën dokumentare të krijuar në kuadër të ankesës, pretendimet apo prapësimet e palës kundër të cilës është ngritur ankesa.
- 3- Vendimin përfundimtar me të cilin është marrë masa/dënimi apo lënia e detyrave për shoqërinë “Log In Albania” lidhur me shkeljet e gjetura nga inspektimi/hetimi.

Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Qarku Tiranë, me shkresën nr. 165 Prot., datë 03.04.2020, i ka kthyer përgjigje kërkuesit në lidhje me kërkesën, si dhe ka refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar me argumentin se: “Bazuar në nenin 9, pikën 1, të ligjit nr. 10 433, datë

16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Inspektorati informon publikun për konstatimet dhe masat e marra gjatë procesit administrativ të inspektimit, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të personave fizikë dhe juridikë. 2. Informimi, sipas parimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, bëhet në bazë dhe brenda kufijve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave që lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale të subjektit të inspektimit apo personave të tjerë. Duke qenë se nuk jeni më pjesë e stafit të punës të subjektit Log In Albania, nuk mund të vendosen në dispozicion dokumenta që përmbajnë të dhëna konfidenciale dhe sensitive për subjektin."

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesi pretendon se nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni i plotë dhe ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, ankesën nr. 560 Prot., datë 20.05.2020, me objekt "refuzimin e dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare", duke kërkuar nga Komisioneri ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit" dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 560/1 prot., datë 26.05.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit.

Në vijim, me shkresën nr. 1038/1 prot., datë 28.05.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 560/2 prot., datë 01.06.2020, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: "*...Në kërkesat e përsëritura z. Hibraraj, pretendon të jetë palë në procedurën e inspektimit duke kërkuar të gjithë dokumentacionin që kontrollon inspektori i punës gjatë një inspektimi për shkak ankese. Por, ashtu si edhe është sqaruar në formë shkresore, denoncimi apo ankesa shërbejnë si indicie për të ushtruar një kontroll të hollësishëm pranë subjektit. Në këtë kontekst, jo të gjitha shkeljet dhe gjetjet gjatë inspektimit ku kontrollohet zbatimi i legjislacionit nga subjekti për të gjithë punëmarrësit, lidhen drejtëpërdrejtë me elementët e ankesës së bërë. Bazuar në pikën 2 dhe 3 të nenit 25 të ligjit nr. 10433/2011 "Për inspektimin në RSH", ku trajtohen çështjet e inspektimit jashtë programi për shkak denoncimi përcaktohet: "...2.Një inspektim, jashtë programit, mund të autorizohet edhe në bazë të një denoncimi apo informacioni të marrë nga të tretët, nëse krijohet dyshimi i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore nga një subjekt. 3. Personi, që ka paraqitur denoncimin apo informacionin, sipas pikës 2 të këtij neni, informohet në përfundim të procedimit të inspektimit për rezultatet e tij, por nuk është palë e procedimit të inspektimit, në kuptimin e Kodit të Procedurave Administrative". Përsa më sipër, z. në të gjithë praktikrat shkresore dhe*

dokumentare të vëna në dispozicion të tij nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (në vijim ISHPSHSH) është informuar hollësisht mbi çdo pretendim dhe gjetje të konstatuar në lidhje me pretendimet e tij. ISHPSHSH-ja në praktikën e saj bazuar në ligj, nuk prodhon vendim përfundimtar ku përmblihet përgjigja e ankesës, por në përfundim prodhon vendim përfundimtar të të gjithë inspektimit të kryer për gjithë shkeljet e legjislacionit të konstatuar në subjekt. Këtë vendim subjekti mund ta afishojë në ambientet e brendshme të aktivitetit për të gjithë punëmarrësit që janë në marrëdhënie pune me të. Duke qenë se z. _____ nuk është pjesë e punonjësve të këtij subjekti, ky vendim nuk mund t'i vendoset në dispozicion. Për sa i përket dokumentacionit të prodhuar gjatë trajtimit të rastit fjalë, i është vënë në dispozicion ajo pjesë e dokumentacionit të cilët nuk e dispononte z. _____ për shkak se është hartuar gjatë procesit inspektues...”

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë, pjesërisht.

Në lidhje me pikën 1 të kërkesës “*Vendimin përfundimtar në të cilin përmblihet përgjigja e ankesës*”, Autoriteti Publik sqaron se nuk prodhon vendim përfundimtar ku përmblihet përgjigja e ankesës, por në përfundim prodhon vendim përfundimtar të të gjithë inspektimit të kryer për gjithë shkeljet e legjislacionit të konstatuara në subjekt. Përsa më sipër, rezulton se Autoriteti Publik nuk e disponon dokumentacionin e kërkuar.

Në lidhje me pikën 2 të kërkesës “*Të gjithë praktikën dokumentare të krijuar në kuadër të ankesës, pretendimet apo prapësimet e palës kundër të cilës është ngritur ankesa*”, Autoriteti Publik pretendon se dokumentacioni i është vënë në dispozicion kërkuarit. Autoriteti Publik argumenton se ka vënë në dispozicion atë pjesë të dokumentacionit të cilët nuk e dispononte z. _____, për shkak se është hartuar gjatë procesit inspektues.

Ky pretendim i Autoritetit Publik nuk qëndron, pasi, ankuesit në kundërshtim me objektin e kërkesës i është vënë në dispozicion vetëm ajo pjesë e dokumentacionit për të cilën Autoriteti Publik pretendon se z. _____ nuk e disponon dhe jo një kopje e të gjithë praktikës dokumentare të krijuar në kuadër të ankesës.

Përsa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar zotërohet nga Autoriteti Publik dhe përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit “*informacion publik konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”, rrjedhimisht i duhet vënë në dispozicion kërkuarit.

Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të administruar në kuadër të inspektimit, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ku përcaktohet se: “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e*

dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Në lidhje me pikën 3 të kërkesës *“Vendimin përfundimtar me të cilin është marrë masa/dënimi apo lënia e detyrave për shoqërinë “Log In Albania” lidhur me shkeljet e gjetura nga inspektimi/hetimi”*, Autoriteti Publik argumenton se, ky dokument mund të afishohet nga subjekti në ambientet e brendshme të aktivitetit për të gjithë punëmarrësit që janë në marrëdhënie pune me të, në këto kushte duke qenë se z. _____ nuk është pjesë e punonjësve të këtij subjekti, ky vendim nuk mund t’i vendoset në dispozicion.

Në lidhje me këtë argument, Zyra e Komisionerit vlerëson se, duke qenë se dokumenti i kërkuar është një dokument i krijuar gjatë ushtrimit të funksionit publik, pra një akt administrativ i përpiluar në kuadër të një hetimi administrativ dhe zotërohet nga Autoriteti Publik, edhe ky dokumentacion përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”* dhe rrjedhimisht i duhet venë në dispozicion kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar.

Në këto kushte, në lidhje me pikat 2 dhe 3 të ankesës së z. _____ ndaj Autoritetit Publik/Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Komisioneri vlerëson se, duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është bazuar në ligj dhe si i tillë duhet pranuar.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit të ligjit nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 560 Prot., datë 20.05.2020 të z. _____, ndaj Autoritetit Publik *“Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore”*, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat 2 dhe 3 (*Të gjithë praktikën dokumentare të krijuar në kuadër të ankesës, pretendimet apo prapësimet e palës kundër të cilës është ngritur ankesa. Vendimin përfundimtar me të cilin është marrë masa/dënimi apo lënia e detyrave per shoqërinë "Log In Albania" lidhur me shkeljet e gjetura nga inspektimi/hetimi.*) të kërkesës për informacion datë 11.03.2020, brenda datës 18.6.2020.
3. Rrëzimin e ankesës për dokumentacionin e kërkuar në pikën 1 (*Vendimin përfundimtar në të cilin përmbledhet përgjigjia e ankesës*) të kërkesës për informacion datë 11.03.2020.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Ky vendim u shpall sot në datë 11.6.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

